

SHTOJCË NR. 2, DATË 06.04.2020

“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 48 muaj, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan dhe qendrat në varësi të tij”, me fond limit 268,475,020 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë pesë mijë e njëzetë) lekë pa TVSH dhe REF-50034-02-11-2020.

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Akt Normativ nr.10, datë 26.3.2020 “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon në dokumentat e tenderit:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

Tek pika 3.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar: ISHTE:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.
2. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

BËHET:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2016, 2017, 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.
2. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Afati kohor për pranimin dhe hapjen e tenderëve, i zgjatur deri më 21.04.2020 Ora 11: 00.

Ofertat do të hapen në faqen zyrtare [www .app.gov.al](http://www.app.gov.al), si dhe në Agjencinë e Blerjes së Përqendruar, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.